



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 577 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 43, datë 20.05.2016

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës),

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vëzhgim Arkeologjik (Survey) në anën perëndimore të luginës së Drinosit, si në Jorgucat, Frashtan, Lugar, Terihat, Lazarat etj.
2. Nuk miratohet vijimi i gërmimit për verifikimin e stratigrafisë së teatrit në zonën e nekropolit.
3. Të realizohet nga Instituti i Arkeologjisë, ruajtja dhe konservimi i strukturave të gjetura më parë.
4. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë korrik-gusht 2016
5. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO